AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), 2022

06.02.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për vitin 2022.

Deficit tregtar më i lartë për 20,1% në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021

Tregtia e mallrave në vitin 2022 kishte deficiti tregtar në vlerë prej 4,7 miliard Euro, që tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (20,1%) krahasuar me vitin 2021, ku edhe në këtë vit kemi bilanc negativ. Totali i eksporteve në këtë vit ishte 920,4 milion Euro, ndërsa importi 5,6 miliard Euro. Eksporti mbulon importin për vetëm 16.3%.

Duke krahasuar të dhënat e eksporteve për mallrat Kosovare gjatë vitit 2022 me atë të vitit 2021 shifrat tregojnë se kemi një rritje vjetore për (21,8%), rritje e cila ka edhe më tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës. Ndërsa të dhënat e tregtisë së mallrave për Importin e Kosovës në vitin 2022 kanë shënuar një rritje vjetore rreth (20,4%) duke krahasuar me vitin paraprak 2021.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 23,11% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 19,53% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar; 13,89% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 11,30 e përbëjnë produktet minerale, 7,56% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 3,62% e përbëjnë produktet bimore, etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 18,54% e përbëjnë produktet minerale; 11,58% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,08% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike; 10,52 e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7,27 e përbëjnë mjetet e transportit; 7,15% e përbëjnë produktet e industrisë kimike; etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	2021		2022	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**755 726**	**100,0**	**920 405**	**100,0**
27 vendet e BE_së	237 747	31,5	311 768	33,9
Cefta	278 443	36,8	333 571	36,2
Të tjera	239 536	31,7	275 066	29,9
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**4 684 198**	**100,0**	**5 639 396**	**100,0**
27 vendet e BE_së	2 076 203	44,3	2 388 798	42,4
Cefta	892 585	19,1	1 000 653	17,7
Të tjera	1 715 411	37	2 249 945	39,9

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 311,8 milion Euro, ose rreth 33,9% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (31,1%). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (9,5%), Italia (5,0%), Holanda (3,2%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 2,4 miliard Euro, ose 42,4% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 15,1%. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (10,8%), Greqia (5,5%), Italia (4,9%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 333,6 milion Euro, ose 36,2% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (19,8%). Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (12,9%), Shqipëria (11,1%), Serbia (6,8%), Mali i Zi (4,2%).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 1,0 miliard Euro, ose 17,7% të importeve të përgjithshme, me një rritje prej (12,1%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (6,6%), Maqedonia e Veriut (5,0%), Shqipëria (4,5%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 275,1 milion Euro, ose 29,9%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: SHBA (14,8%) dhe Zvicra (7,6%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 2,2 miliard Euro, ose 39,9%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14,9%) dhe Kina (9,7%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për vitin 2022, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade